

## Ndryshime në vepër: Monitorimi i Strategjisë nacionale për luftë kundër korrupsionit

Strategjia nacionale për luftë kundër korrupsionit është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në prill të vitit 2021. Paraqet dokument gjithëpërfshirës që ofron udhëzimet bazë për plan reformash që synon të luftojë korrupsionin. Krahas udhëzimeve dhe temave të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit, Strategjia parashikon angazhime konkrete që do të ndërmerren nga disa institucione - disa kanë marrë detyra, sepse punojnë në tema me rrezik të lartë nga korrupsioni, ndërsa të tjera sepse janë drejtpërdrejt kompetente të punojnë në çrënjosjen (parandaluese ose represive).

Megjithatë, reformat në këtë fushë shpesh janë të gjata, kanë të bëjnë me forcimin institucional dhe shpeshherë vështirë vërehen nga qytetarët. Tendenca e institucioneve është të formësojnë reformat të fokusuara në vetë ato. Duke pasur parasysh sfidat e mëdha që lidhen me kapacitetet e institucioneve, reformat kanë të bëjnë më së shumti me fuqizimin e potencialit njerëzor dhe ndryshimin e procedurave.

Përqendrimi i brendshëm i institucioneve dhe jetëgjatësia e reformave janë një faktor rëndësues kur duhet të fitohet besimi i qytetarëve. Ata, presin rezultate të menjëhershme, kështu që efekti i vonuar përforcon ndjenjën se nuk mund të bëhet asgjë kundër korrupsionit. Pikërisht ky disfatizëm është problem i rëndësishëm sistematik, sepse suksesi kundër korrupsionit në botë është pothuajse ekskluzivisht rezultat i veprimit kolektiv shoqëror. Që të ndodhë kjo, duhen aleatë të motivuar në mesin e qytetarëve.

Prandaj Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit duhet të gjejë të gjitha kanalet e mundshme përmes të cilave do të rritet entuziazmi i qytetarëve.

Një mundësi për këtë është prezantimi i rrugës reformuese të vendit, përmes tregimit të dobisë nga ndryshimet në jetën e përditshme të qytetarëve. Megjithatë, aktualisht treguesit për monitorimin e zbatimit të strategjisë lidhen me aktivitetet. Kjo informon se sa nga aktivitetet kanë filluar ose përfunduar. Por kjo nuk do të thotë se palët e interesuara, dhe veçanërisht qytetarët, do të marrin informacion se çfarë suksesi është arritur.

Prandaj, KSHPK-ja, ka mundësi që gjatë mbledhjes së informacioneve për progresin e Strategjisë, të dërgojë disa pyetje shtesë me të cilat institucionet do të vlerësojnë cilësisht se si e kanë përmirësuar jetën e qytetarëve duke përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre dhe luftën kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, KSHPK-ja do të vendosë risi në mënyrën e raportimit, sepse raportimi i suksesshëm më shumë paraqet përjashtim sesa rregull në institucione.

Projekti "Biseda anti -korrupsion në Kuvend (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) përfshin aktivitete kërkimore dhe përfaqësuese me qëllim kryesor, mbështetjen e procesit reformues në Maqedoninë e Veriut, përmes forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti mbështetet nga Fondi Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen është përgjegjës IDSCS dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Fondit Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED).

